



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 173, Datë 22.06.2026

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 3” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1101/9 prot., datë 18.06.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 3” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SPV Blue 3” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101 prot., datë 08.04.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik “Blue 3”, me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 36 MW, për një afat 30-vjeçar.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 106, datë 21.04.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.04.2026 dhe 23.04.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.05.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1101/3 prot., datë 27.04.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjes dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur një përgjigje.
- Me shkresën nr. 1101/4 prot., datë 27.04.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit/informacionit të munguar.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101/5 prot., datë 05.05.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion shtesë, nga analizimi i të cilit u vlerësua i nevojshëm zhvillimi i komunikimit të mëtejshëm me shoqërinë për sa i përket korrespondencës së zhvilluar me MIE-n në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta dhe nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare. Si e tillë, ERE iu drejtua me shkresën me nr. 1101/6 prot., datë 25.05.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101/7 prot., datë 28.05.2026 dhe e-mailin e datës 17.06.2026, shoqëria ka depozituar komunikimin e zhvilluar me MIE-n në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta, ku MIE shprehet parimisht dakord për krijimin e shoqërisë “SPV Blue 3” shpk. Rezulton se nuk është nënshkruar ende Marrëveshja Përfundimtare, por duke qenë se vetë shoqëria ka parashikuar se do të vendosë në punë centralin brenda muajit shtator 2028, vlerësohet t’i lihet kusht që të raportojë në ERE për nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare brenda datës së parashikuar nga ana e saj për operimin, pra brenda datës 30.09.2028.
- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

### **Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:**

- Shoqëria “SPV Blue” sh.p.k. ka depozituar në ERE “Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit Fotovoltaik Blue 3 me një kapacitet të instaluar prej 36 MWac dhe Kapacitet të Mbështetur prej 36 MWac që do vendoset në Sheq Marinas, Fier, nr. 6122/3 prot., datë 10.12.2024, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “BLESSED INVESTMENT” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k.

Po ashtu, rezulton se shoqëria:

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik Blue 3”, në datën 24.10.2025.
- Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake nr. AN090720250011, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, më 29.10.2025, për zhvillimin e projektit “PARKU FOTOVOLTAIK- Blue 3”.

### **Kushtet dhe afatet ligjore:**

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë për panelet nga ku rezulton se jetëgjatësia e tyre është 30 vjet, si e tillë dhe licenca e ERE-s do të ketë një vlefshmëri prej 30 vitesh.
- Shoqëria ka kërkuar që afati 30-vjeçar të fillojë me operimin e veprës, pas kalimit të provës 72-orëshe të testimit dhe komisionimit nga OST sh.a. Sa kërkuar nga shoqëria vlerësohet se mbështetet dhe në Marrëveshjen e zhvillimit të Projektit, të nënshkruar më datë 10.12.2024 me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku në faqen 4 të saj referohet se data e operimit tregtar nënkupton fillimisht orën 00.00 (ora lokale) të datës që vjen menjëherë pas datës në të cilën është kryer Kolaudimi, ndaj afati i vlefshmërisë së licencës së shoqërisë vlerësohet të fillojë nga kolaudimi i veprës.
- Shoqëria disponon një VNM Paraprake të vlefshme deri në datën 29.10.2027, dhe vetë shoqëria ka bërë me dije në Shtojcën 2 që punimet do të fillojnë në vitin 2027, ndaj vlerësohet t’i lihet detyrë që të depozitojë në ERE informacion periodik, çdo 3 muaj, për

fillimin e punimeve deri jo më vonë se afati përfundimtar i VNM-së Paraprake, pra deri më 29.10.2027.

- Rezulton se shoqëria nuk ka nënshkruar ende Marrëveshjen Përfundimtare, por duke qenë se vetë shoqëria ka parashikuar se do të vërë në punë centralin brenda muajit shtator 2028, vlerësohet t'i lihet kusht që të raportojë në ERE për nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare brenda datës së parashikuar nga ana e saj për operimin, pra brenda datës 30.09.2028.
- Po ashtu, në lidhje me sa parashikuar në pikën 6.8 të Marrëveshjes së Zhvillimit të nënshkruar me MIE-n, në lidhje me procedurën e kolaudimit të veprës, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të depozitujë në ERE dokumentacionin përkatës.
- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “SPV Blue 3” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik “Blue 3”, me kapacitet të instaluar 36 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga kolaudimi i veprës.
2. Shoqëria duhet të depozitujë në ERE informacion periodik (çdo 3 muaj) për fillimin e punimeve deri më 29.10.2027.
3. Shoqëria duhet të raportojë në ERE për nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare brenda datës 30.09.2028.
4. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga kolaudimi i veprës, shoqëria duhet të depozitujë në ERE dokumentacionin përkatës të kolaudimit.
5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 3” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**